

FJALA E DEPUTETES MIRELA KUMBARO

E ENJTE 17 MARS 2022

Të nderuar kolegë,

“Neve na gënjen mendja se jemi të plotfuqishëm përballë tokës! Në fakt, na duhet sa më shpejt të kuptojmë se ç’po i bëjmë tokës, ç’po i bëjmë jetës. Po e vrasim! Të hedhësh qeset dhe plastikën në lumë, në det, ke bërë një krim. Ke vrarë!”. Këto ishin fjalët e Papa Françeskut në meshën e të dielës të para pak javëve. Ndërsa Shqipëria vetëm pak ditë më parë iu bashkua deklaratës së programit të Kombeve të Bashkuara për mjedisin për të marrë masa konkrete të thella, si asnjëherë më parë, kundër produkteve plastike njëpërdorimshme, që sot janë kthyer në një tjetër epidemi për botën.

Në këtë frymë, po të doni të Atit të Shenjtë, po të doni të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, ku sot krenarisht jemi edhe anëtarë të Këshillit të Sigurimit, prezantoj para jush dhe, sidomos para opinionit publik ndryshimet në ligjin nr. 10 463 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i cili është miratuar dhe ka hyrë në fuqi në vitin 2011. Në përmbajtje të këtij akti rregullohen, në parim, mënyrat e trajtimit të mbetjeve, duke i ndarë ato në kategori e procese të ndryshme. Njëra nga kategoritë e mbetjeve, të cilat për shkak të prezencës dhe kontaktit të tyre të përditshëm me çdo qytetar, është edhe qesja plastike mbajtëse. Është pikërisht kjo që kam këtu përpara. Kjo është në kontakt të përditshëm me të gjithë ne, e cila përfshihet në llojin e mbetjeve të prodhuara nga ambalazhet, sipas VKM-së nr. 177/2012. Pikërisht, projekti që paraqesim sot, dhe që kam bindjen se e keni votuar tashmë, ka si objekt që të ndërhyjmë në këtë ligj, konkretisht në përmbajtjen e neneve 3, 29 dhe 62 të ligjit.

Unë e di që e keni votuar. Kështu që ia vlen të dëgjoni se për çfarë e keni votuar. Amendimet që propozojmë, synojnë ndalimin e tregtimit, prodhimit, importimit të qeseve plastike mbajtëse, sipas përcaktimit të këtij ligji, me trashësi për çdo anë më të vogël se 70 mikronë dhe me kapacitet mbajtës më të vogël se 10 kilogramë; gjithashtu, kontrollin e zbatimit të këtyre dispozitave dhe ndëshkimin e shkeljes së tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë. Është fjala për qeset plastike mbajtëse që, sipas përkufizimit të dhënë në projektligjin e propozuar, është qesja mbajtëse, transportuese me ose pa vesh, e prodhuar nga plastika, e cila jepet në pikat e tregtimit apo shpërndarjes të mallrave të të gjitha kategorive dhe produkteve. Të gjithë e dimë që këto lloje qesesh shpërndahen pa hesap, falas, si për një kokërr mollë, edhe për një bostan! Prandaj i kemi të gjithë nëpër duar.

Në të gjitha relacionet dhe shpjegimet që kemi bërë në komisionet parlamentare, por edhe në daljet tona publike, është i qartë objektivi i Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, si iniciuese e këtij ligji. Është po ai prioritet që Kryeministri e ka deklaruar në ditën e parë të mandatit të kësaj qeverie: ndalimi i qeseve plastike, pra i atyre kategorie qesesh që shërbejnë për qëllime njëpërdorimi në supermarkete, dyqane apo aktivitete tregtie me natyrë të ngjashme në Republikën e Shqipërisë, si masë e parë reaguese ndaj reduktimit të plastikës njëpërdorimshme, si masë e domosdoshme për të frenuar dhe për të pastruar territorin e Shqipërisë nga ndotja e pislëku, sidomos për t’u garantuar fëmijëve tanë një Shqipëri të shëndetshme dhe një mjedis miqësor me jetën. Të gjithë e dimë se e kemi pasur objektiv këtë nismë që

në mandatin e dytë, kur u depozitua projektligji në Kuvend, por fatkeqësitë natyrore dhe shëndetësore, që kaluam nga 2019- ta e në vazhdim, na e ndërprejnë këtë iniciativë. Ndërprerja ishte e përkohshme, sepse kemi bindjen e palëkundur për angazhimin që kemi marrë për Shqipërinë e pastër që duam t'u lëmë fëmijëve.

Shkak për ndërmarrjen e kësaj iniciative janë rezultatet negative të pasqyruara në raportet e përvitshme të gjendjes në mjedis, në atë ujor dhe tokësor, si pasojë e prezencës së lartë dhe tejet jetëgjatë të plastikës. Më lejoni të sjell në vëmendje se cilët janë faktorët që e bëjnë të domosdoshme më shumë se kurrë këtë nismë. Së pari, prezenca aktuale e plastikës njëpërdorimshe në çdo hapësirë, ujore, tokësore, si në ajër, në tokë, në det. Më lejoni të sjell këtu disa pamje, të cilat, ndoshta, janë shokuese kur i shikojmë në fotografi, por janë thjesht realitet, disa prej fotografive janë marrë gjatë planit të pastrimit kombëtar, që kemi filluar të zbatojmë çdo ditë në territorin e Shqipërisë. Është mirë ta dimë se çfarë po i bëjmë tokës. Janë të gjitha foto të marra nga territori i Republikës së Shqipërisë, janë të trashëguara, të reja, të përhapura. Nuk i shohim, sepse nuk janë në hapësirat tona urbane, në qendrat e qyteteve, por janë ato që ne kemi hedhur në vite, në dekada dhe pastaj na rikthehen në rrugë të ndryshme sërish brenda jetës sonë.

Në fakt, kjo prezencë e këtyre qeseve, të cilat vazhdojnë të tregtohen dhe të përdoren janë helmuese. Nga ana tjetër, ka një interes të ulët, dhe kjo përbën një tjetër arsye pse, pothuajse inekzistent për grumbullimin dhe trajtimin e kësaj kategorie mbetjesh në mënyra të ndryshme nga ai i asgjësimit. Ineficienca dhe kostot e larta në mbikëqyrjen e sjelljes së qytetarit dhe tregut në lidhje me mënyrën e përdorimit dhe tregtimit të produktit të qeseve plastike mbajtëse janë një tjetër faktor. Ajo që thashë pak më parë, shpërndarja, dhënia, lëshimi, hedhja pa hesap, i bën që ato të jenë gjithmonë e më shumë me shumicë në territorin e Shqipërisë. Por kemi edhe një detyrim për të ecur paralel me masat, që janë ndërmarrë nga shumica e shteteve anëtare të BE-së, me qëllim reduktimin e përdorimit të plastikës njëpërdorimshe. Sigurisht, kemi detyrimin për t'u përfruar me direktivën e vitit 2019 të BE-së, por sot në fillim të fjalës sime ju fola për një iniciativë globale. Shqetësim për këtë është jo vetëm situata në Shqipëri, sepse nuk ka kufij, nuk ka pasaporta, nuk ka viza kur flasim për mjedisin. Shqetësimi dhe frika për të ardhmen është po aq globale.

Ekspertët e mjedisit kanë llogaritur se në oqeanet e botës lundrojnë nga 100-150 milionë tonë mbeturina. Sipas po të njëjtave të dhëna, rreth 6,5 milionë tonë mbetje plastike shtohen çdo vit. Sipas Organizatës së Kombeve të Bashkuara, në çdo kilometër katror të oqeaneve gjenden rreth 130 mijë pjesë plastike, që transportohen më pas me anë të rrymave oqeanike. Do të thoni se po ju flas për botën. Jo. Ja, t'ju tregoj këtë fotografi! Është thjesht fundi i detit, në Gjirin e Porto Romanos, marrë nga zhytësit tanë. Këtë i kemi bërë ne detit, jo vetëm tokës. Po ju jap edhe një ilustrim tjetër nga Shqipëria. Sipas studimit të bërë nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, në bashkëpunim me GIZ, kooperacionin gjerman, në vendet që lagen nga deti Adriatik 80% e mbetjeve në det vjen nga toka, përmes lumenjve që derdhen në det. Nga këto 90% janë materiale plastike dhe ambalazhe plastike. Me rreth 80 mijë e 400 ton në vit mbetje plastike të keqmenaxhuara, të hedhura tej e tej në territor, përtej kufijve të qyteteve, Shqipëria është një ndër pesë vendet më ndotëse të Adriatikut. Shqipëria ndot me 3, 2 miliardë qese plastike, që do të thotë me tri qese plastike në ditë për një njeri, e barabartë kjo me 26 mijë e 280 ton qese plastike në vit.

Era i transporton këto qese, për shkak të peshës së tyre të lehtë, duke mbuluar zona të tëra, si dhe duke veshur degët e pemëve e brigjet e lumenjve. Pak vëmendje! Në këtë foto kemi një nga ato instalacionet e tmerrshme, që duken si filma fantastiko-shkencorë, por që është thjesht lumi i Vjosës, për të cilin llobohet aq shumë, në lidhje me të cilin po punojmë për një projekt zhvillimi të qëndrueshëm, që e shpallëm park natyror dhe po punojmë të rrisim shkallën e mbrojtjes drejt parkut kombëtar. Por ç'kuptim ka të marrim vendime, të shpallim zona të mbrojtura, ndërkohë që me dekada është kjo çfarë i bëjmë ne Vjosës, Ulzës, Lumit të Shalës, Liqenit të Fierzës e kështu me radhë. Në fakt, po jua them këtë në emër të skuadrave të dymbëdhjetë qarqeve, të 61 bashkive dhe qindra punonjësve të administratës publike, të cilët nga 1 nëntori, kur nisëm planin e pastrimit kombëtar, janë çdo ditë në terren, çdo ditë të Perëndisë, duke pastruar plehrat që ne kemi hedhur në rrëzat e maleve, në rrëzat e kodrave e nëpër pyje që prej më shumë se tridhjetë vjetësh.

Duhet të dimë një gjë: qeset plastike nuk degradohen, nuk shpërbëhen, e nëse degradohen, kjo ndodh pas një shekulli ose pas disa shekujsh. Në vend që të degradohet, plastika thjesht ndahet e thërrmohet në copëza të vogla, të cilat pastaj përfundojnë në lumenj, në dete, në oqean, e më pas konsumohen nga të gjitha gjallesat: peshqit, kafshët e egra e kështu me radhë. Aktualisht, rreth 46 mijë deri në 1 milion fragmente plastike janë duke lundruar brenda çdo miljeje katror të deteve dhe oqeanëve të globit. Janë të dëmshme për faunën e egër, për zogjtë, kafshët, për të gjitha gjallesat detare, që nga breshkat e deri te peshqit, të cilët shpesh ngatërrojnë qesen plastike dhe materialet e tjera plastike me ushqimin, kështu që i konsumojnë ato. Siç raporton fondacioni "Ellen MacArthur", nëse nuk ngadalësojmë prodhimin dhe përdorimin e qeseve plastike, e ardhmja duket e zyrtë, sepse deri në vitin 2050 në oqean do të ketë më shumë plastikë sesa peshq. Qeset plastike nuk janë të lehta për t'u ricikluar, sepse përbëjnë një sfidë për gjithë biznesin e riciklimit si në Shqipëri, ashtu dhe kudo tjetër. Përfaqësuesit e industrisë ricikluese në vend nuk kanë interes të riciklojnë qeset plastike, e për rrjedhojë, më së shumti nuk i pranojnë ato.

Prandaj, shkalla aktuale e riciklimit për qeset plastike është rreth 5% dhe jo më shumë. Duke qenë se kjo përqindje është edhe në nivel global, duhet theksuar se në Republikën e Shqipërisë, për shkak të mosfunksionimit të ndarjes së mbetjeve në burim, qeset plastike nuk përfshihen pothuajse fare te materialet e riciklueshme, për shkak të ndotjes që pësojnë duke u përzierë me të tjera mbetje, gjë që na sjell një tjetër sfidë. Qeset plastike, për të cilat po flasim, janë njëpërdorimëshe dhe nuk mund të përdoren disa herë, sepse duke u shpërndarë falas, madje duke hyrë herë pas here edhe kontrabandë, siç thonë ricikluesit, ato kontaminojnë gjithë territorin. Qeset plastike për të cilat po flasim, janë projektuar dhe prodhuar për të qenë njëpërdorimëshe. Sondazhet kanë treguar se qeset plastike të transportit – pra po i rikthehem prapë kësaj gjëse së zezë e të tmerrshme – përdoren maksimumi për rreth 12 minuta e më pas hidhen. Disa përdoren disa herë, por pjesa më e madhe hidhet menjëherë. 88% e qeseve plastike hidhen në mënyrë të parregullt dhe vetëm 12% e tyre mund riciklohen, sipas Agjencisë Kombëtare të Mjedisit.

Qeset plastike priren të jetojnë për shekuj me radhë. Ato nuk degradohen kurrë plotësisht, gjë që tregon se sa më shumë që prodhohen, aq më shumë futen në mjedis, aq më shumë helmojnë, aq më shumë ndotin territorin. Prandaj, sa më e madhe të jetë sasia e qeseve plastike, aq më e madhe është ndotja, aq më të mëdha janë efektet e tyre negative. Ndalimi i përdorimit të qeseve plastike do të ndihmojë në

uljen e këtij efekti ndotës, helmues e madje edhe kancerogjen. Përvoja e vendeve të tjera ka treguar se reduktimi i plastikës njëpërdorimëshe nuk mund të bëhet vetëm nëpërmjet edukimit, por nëpërmjet masave konkrete: duke ndaluar një kategori produktesh; duke trajtuar ndarjen në burim sipas kodeve përkatëse të atyre mbetjeve që përbëjnë interes për riciklim. Nëse sot po kërkojmë me çdo kusht, që të ndalojmë prodhimin dhe tregtimin e qeseve plastike njëpërdorimëshe, sfida jonë e madhe si shoqëri dhe si qeverisje vendore mbetet ndarja që në burim e rrymave të mbetjeve. Në fakt, vetëm kjo do duhet të jetë e ardhmja e afërt. Rrugë tjetër për të ulur volumin e mbetjeve që prodhojmë nuk gjejmë dot, sepse nuk e ka gjetur dot njeri tjetër para nesh apo në vendet e tjera paralel me ne. Qeset kanë ngjyra të ndryshme, të nderuar kolegë, por nuk kanë flamuj të ndryshëm politikë, siç nuk kanë të tilla të gjitha mbetjet që ne prodhojmë. Në një kosh i derdhim të gjithë.

Prandaj, ndërsa kam çmuar sinqerisht fjalët e disa prej kolegëve të opozitës në komisione, që e vlerësuan me zë e zemër këtë projektligj, ndonëse nuk e votuan me votë në komision, por më lejoni t'ju bëj një thirrje: sot në mëngjes apo sonte në darkë, kur të dalim nga kjo sallë, të mos harrojmë se në një kosh do t'i hedhim plehrat, të njëjtin ushqim do të konsumojmë, në të njëjtin qytet i rrisim fëmijët dhe në të njëjtin det do të lahem në verë. Prandaj, nëse një javë më parë e gjithë bota u bashkua në marrëveshjen globale kundër plastikës njëpërdorimëshe në gjirin e OKB, ia vlen të bashkohemi në emër të tokës, të detit, të ushqimit dhe të ajrit, që ndajmë bashkë pa votë. Unë mezi pres të shoh rezultatin e votimit që sapo bëtë. Me zemër dhe nëpër korridore më keni përgëzuar, domethënë keni përgëzuar qeverinë për këtë iniciativë, ndërsa sa i takon mbështetjes me votë, uroj shumë të keni dëgjuar zërin e fëmijëve tuaj, sepse të gjitha këto: tokën, ajrin, ujin, ne nuk i kemi trashëguar nga askush, por vetëm ua kemi marrë borxh fëmijëve tanë, ndaj dhe të pastër do të duhet t'ua kthejmë. Shumë falemnderit!